

Biljana Kërsteska
Jasmina Markoska

MATEMATIKA

për vitin II arsim i mesëm
profesional katërvjeçar

Shëndetësi dhe politikë sociale

Tekstil-lëkurë

Bujqësi, peshkatari dhe veterinari

Shërbime personale

Pylltari dhe përpunimi i drurit

MATEMATIKA

për vitin II

arsim i mesëm profesional katërvjeçar

SEKTORI/PROFESIONI: Shëndetësor/Shëndetësi dhe politikë sociale

Bujqësor-veterinar / Bujqësi, peshkatari dhe veterinar

Shërbime personale, Tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme /Tekstil-lëkurë

Pylltari dhe përpunimi i drurit /Pylltari dhe përpunimi i drurit

Autore:

Biljana Kërsteska, Jasmina Markoska

Recensentë:

Aneta Gacovska

Emilija Boshkovska-Zhivadinoviq

Violeta Peshevsk

Ilustrimet: Biljana Kërsteska, Jasmina Markoska

Titulli i origjinal:

МАТЕМАТИКА

за II година на средното стручно

четиригодишно образование

Здравствена струка

Земјоделско-ветеринарна струка

Лични услуги

Текстилно-кожарска струка

Шумарско-дрвопреработувачка струка

Билјана Крстеска

Јасмина Маркоска

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54 1000 Shkup.

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Muzafer Beqiri

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Xhevair Beqiri

Lektor: Refail Sulejmani

Redaktimi grafik dhe teknik: Leon Xhingo, Evgenija Pavlova - ARS STUDIO

Redaktor: Refail Sulejmani

Vendi dhe viti i botimit: Shkup 2023

Me vendimin për lejimin e tekstit shkollor MATEMATIKA, për vitin II të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar (SEKTORI/PROFESIONI: Shëndetësor/Shëndetësi dhe politikë sociale, Bujqësor-veterinar / Bujqësi, peshkatari dhe veterinar, Shërbime personale, Tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme / Tekstil-lëkurë, Pylltari dhe përpunimi i drurit /Pylltari dhe përpunimi i drurit). Nr. 26-303/1 të datës 8.7.2022 të miratuar nga Komisioni kombëtar për tekste shkollore.

PARATHËNIE

Teksti MATEMATIKA për vitin e dytë të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar është shkruar sipas programit mësimor për lëndën e detyrueshme të përmendur. I dedikuar për nxënësit nga profesioni Shëndetësi, profesioni Bujqësor-veterinare, Shërbime personale, profesioni Tekstil-lëkurë dhe Pylltari – përpunimi i drurit.

Autoret tentojnë t'i përpunojnë përmbajtjet e parashikuara në pajtim me udhëzimet didaktike-metodike për realizimin e programit. Teksti është modulare e dizajnuar dhe përbëhet prej tetë tërësive tematike:

- RRËNJËT
- FUNKSIONET TRIGONOMETRIKE NË TREKËNDËSHIN KËNDËDREJTË
- NUMRAT KOMPLEKS
- BARAZIMI KATROR
- BARAZIMET E LLOJIT KATROR. BARAZIMET IRACIONALE. SISTEMI PREJ NJË BARAZIMI KATROR DHE NJË BARAZIMI LINEAR ME DY TË PANJOHURA
- FUNKSIONI KATROR, PABARAZIMI KATROR, SISTEMI PREJ DY PABARAZIMEVE KATRORE ME NJË TË PANJOHUR
- VEKTORËT NË RRAFSH. FIGURAT GJEOMETRIKE NË HAPËSIRË
- SYPRINA DHE VËLLIMI I TRUPAVE GJEOMETRIK

Në kuadër të çdo teme mësimore janë punuar përmbajtjet e parapara, të cilat, sipas rregull, janë ilustruar me shembuj të zgjidhur dhe vizatime. Në fund të çdo njësie mësimore janë dhënë detyra për punë të pavarur ose për detyrë shtëpie, që paraqet vazhdimë të punës së orës, kurse në fund të çdo teme mësimore janë dhënë detyra për përsëritje dhe përforcim të materialit. Zgjidhjet dhe përgjigjet e detyrave, kurse sipas zgjedhjes së autoreve, diku edhe udhëzime për zgjidhjen e tyre, janë dhënë në fund të tekstit mësimor.

Autoret prej përpara do të jenë të falënderuar për çdo kritikë me qëllim të mirë ose vërejtje për përmirësimin e përmbajtjes, pasi besojnë se ky tekst do të kontribuojë që nxënësit më shumë ta duan matematikën dhe të hyjnë në fshehtësitë e saj.

Autoret

1. RRËNJËT

1.1. Koncepti për rrënjë

Konceptet rrënja katrore dhe kubike prej numrit të dhënë pozitiv tanimë i ke të njohur prej arsimit fillor. Mbetet ta zgjerojmë atë koncept deri te rrënja n prej numrit real.

Përkufizimi. Numri real pozitiv x , për të cilin vlen $x^n = a$, ku a është numër real pozitiv dhe $n \in \mathbb{N}$ quhet **rrënja katrore n prej numrit a** dhe shënohet me $x = \sqrt[n]{a}$.

Poashtu, n quhet **treguesi i rrënjës**, kurse a quhet **shprehja nënrrënjë ose radikand**.

Shembull 1. Rrënja $\sqrt[4]{16}$ ka tregues të rrënjës 4, shprehja nënrrënjë 16 dhe $\sqrt[4]{16} = 2$, pasi $2^4 = 16$, kurse $\sqrt[5]{100000} = 10$, pasi $10^5 = 100000$!

Operacioni me të cilin e caktojmë vlerën e $\sqrt[n]{a}$ kur na janë të njohura vlerat e n dhe a , quhet **rrënjëzim**.

Nëse $n = 2$, atëherë në vend $\sqrt[2]{6}$ shkruajmë $\sqrt{6}$ dhe lexojmë **rrënja katrore** e numrit 6 ose vetëm **rrënjë** e numrit 6.

Detyra 1. Njehso:

a) $\sqrt{25}$, b) $\sqrt[3]{27}$, c) $\sqrt[4]{81}$.

Zgjidhje. !) $\sqrt{25} = 5$ pasi $5^2 = 25$, **b)** $\sqrt[3]{27} = 3$ pasi $3^3 = 27$, **c)** $\sqrt[4]{81} = 3$ pasi $3^4 = 81$!

Prej përkufizimit vijon se $\sqrt[n]{a}$, ku $a > 0$ dhe $n \in \mathbb{N}$ është numër pozitiv i atillë ku fuqia n është e barabartë me a d.m.th. $(\sqrt[n]{a})^n = a$.

Ngjashëm edhe $\sqrt[n]{a^n} = a$, ku $a > 0$ dhe $n \in \mathbb{N}$, pasi $a^n = (a)^n$.

Shembulli 2. $(\sqrt[3]{3})^3 = 3$ dhe $\sqrt[6]{b^6} = b$, për $b > 0$!

Le të jetë n numër çift natyror. Të mundshme janë këto situata:

- Nëse $a > 0$, atëherë ekzistojnë dy numra realë të kundërt për të cilët vlen $x^n = a$ dhe me $\sqrt[n]{a}$ e shënojmë numrin pozitiv (e quajmë **rrënja n e numrit a**), kurse me $-\sqrt[n]{a}$ numri i tij i kundërt.
- Nëse $a = 0$, atëherë ekziston numër real i vetëm x (numri 0) ashtu që $x = \sqrt[n]{0}$.
- Nëse $a < 0$, atëherë nuk ekziston numër real x , ashtu që $x^n = a$, pra sipas kësaj shprehjeje $\sqrt[n]{a}$ nuk ka kuptim.

Le të jetë n numër natyror tek. Atëherë ekziston numër real i vetëm x ashtu që $x^n = a$, për çfarëdo numër real a .

Shembulli 3. Rrënjët $\sqrt{-4}$, $\sqrt[4]{-16}$ dhe $\sqrt[8]{-32}$ nuk kanë kuptim në bashkësinë e numrave realë, rrënjët $\sqrt[3]{-343}$, $\sqrt[15]{-1}$ dhe $\sqrt[7]{-128}$ kanë kuptim dhe mund të njehsohen, kurse rrënja $\sqrt[6]{x+2}$ ka kuptim për të gjithë numrat realë x për të cilët vlen $x+2 \geq 0$ d.m.th., $x \geq -2$!

Prandaj, për n numër natyror çift vlen ky rregull:

$$\sqrt[n]{a^n} \begin{cases} a, & \text{për } a \geq 0 \\ -a, & \text{për } a < 0 \end{cases}$$

Kur n është numër natyror tek vlen $\sqrt[n]{a^n} = a$, për çdo numër real a .

Detyra 2. Thjeshtoji shprehjet:

a) $\sqrt[4]{(-3)^4}$, **b)** $\sqrt[12]{(-1)^{12}}$, **c)** $\sqrt[6]{4^6}$, **ç)** $\sqrt[3]{(-2)^3}$, **d)** $\sqrt{(x+1)^2}$

Zgjidhje. a) $\sqrt[4]{(-3)^4} = |-3| = 3$, pasi $n = 4$ është numër çift dhe $a = -3 < 0$,

b) $\sqrt[12]{(-1)^{12}} = |-1| = 1$, pasi $n = 12$ dhe $a = -1 < 0$,

c) $\sqrt[6]{4^6} = 4$, pasi $n = 6$ dhe $a = 4 \geq 0$,

ç) $\sqrt[3]{(-2)^3} = -2$, pasi $n = 3$ është numër tek,

d) $\sqrt{(x+1)^2} = |x+1| = \begin{cases} x+1, & \text{për } x \geq -1 \\ -(x+1), & \text{për } x < -1 \end{cases} \cdot \blacklozenge$

Detyra

1. Njehso:

a) $\sqrt{121}$, **b)** $\sqrt[4]{0,0016}$, **c)** $\sqrt[4]{\frac{81}{256}}$, **ç)** $\sqrt[5]{\frac{1}{32}}$.

2. Cilët prej këtyre rrënjëve kanë kuptim në bashkësinë e numrave realë?

a) $\sqrt[4]{-0,01}$, **b)** $\sqrt[3]{-125}$, **c)** $\sqrt[6]{\frac{6^2}{(-2)^3}}$, **ç)** $\sqrt{\frac{2}{3} - \frac{3}{4}}$.

3. Cilët prej këtyre rrënjëve kanë kuptim në bashkësinë e numrave realë?

a) $\sqrt{\frac{4}{3} - \frac{3}{5}}$, **b)** $\sqrt[3]{3 + \frac{1}{2} - \frac{2}{5}}$, **c)** $\sqrt[4]{0,01 - 0,0(1)}$, **ç)** $\sqrt[12]{\frac{1}{2,3-7^2}}$

4. Për cilat vlera të shprehjes nënrrënjë, rrënja ka kuptim?

a) $\sqrt[5]{2x+3}$, **b)** $\sqrt[4]{20+4x}$, **c)** $\sqrt[3]{2x+1}$, **ç)** $\sqrt[6]{(x-2)(x+3)}$

5. Thjeshto:

a) $\sqrt[2]{(-2)^4}$, **b)** $\sqrt{\frac{1600}{(-200)^2}}$, **c)** $\sqrt[3]{\left(-\frac{1}{8}\right)^3}$, **ç)** $\sqrt{(16-2x)^2}$ për $x \geq 8$.

1.2. Zgjerimi dhe thjeshtimi rrënjëve

Në vazhdimë do të shqyrtojmë disa veti të rrënjëve me ndihmën e të cilave në të ardhmen do të mund të kryejmë transformime dhe thjeshtime.

Teorema. Nëse a është numër real pozitiv, kurse m , n dhe k janë numra natyrorë, atëherë vlen $\sqrt[n]{a^m} = \sqrt[n-k]{a^{m-k}}$ (**zgjerim** të rrënjës $\sqrt[n]{a^m}$ me numrin natyror k).

Me të vërtetë, për nk fuqia e numrit $\sqrt[n]{a^m}$ kemi:

$$(\sqrt[n]{a^m})^{nk} = \left[\left(\sqrt[n]{a^m} \right)^n \right]^k = (a^m)^k = a^{mk}.$$

Sipas përkufizimit për rrënjën vijon se $\sqrt[n]{a^m} = \sqrt[n-k]{a^{m-k}}$. $\blacklozenge$

Shembulli 1. Rrënja $\sqrt[3]{2}$ e zgjeruar me 5 është $\sqrt[3 \cdot 5]{2^{1 \cdot 5}} = \sqrt[15]{2^5}$, ndërsa tani rrënja $\sqrt[5]{3^5}$ e zgjeruar me 2 është $\sqrt[2 \cdot 5]{3^{5 \cdot 2}} = \sqrt[10]{3^{10}}$. ♦

Detyra 1. Rrënjët $\sqrt[3]{ab^2}$ dhe $\sqrt[4]{a^3b}$ zgjeroji deri te treguesi i përbashkët më i vogël, ku $a, b > 0$

Zgjidhje. Prej kësaj që sHVP (3,4) = 12 fitohet se rrënja e parë duhet të zgjerohet me 4, kurse e dyta me 3, pra fitohen rrënjët

$$\sqrt[3]{ab^2} = \sqrt[3 \cdot 4]{(ab^2)^{1 \cdot 4}} = \sqrt[12]{a^4b^8} \text{ dhe } \sqrt[4]{a^3b} = \sqrt[4 \cdot 3]{(a^3b)^{1 \cdot 3}} = \sqrt[12]{a^9b^3}, \text{ përkatësisht. } \blacklozenge$$

Ngjashëm me teoremën paraprake vërtetohet edhe teorema vijuese:

Teorema. Nëse a është numër real pozitiv, kurse m, n dhe k janë numra natyrorë të atillë që $k|n$ dhe $k|m$, atëherë $\sqrt[n \cdot k]{a^{m \cdot k}}$ (**thjeshtimi** i rrënjës $\sqrt[n]{a^m}$ me numrin natyror k).

Shembulli 2. Rrënja $\sqrt[9]{27}$ mund të thjeshtohet me 3, pra fitohet rrënja $\sqrt[9 \cdot 3]{3^{3 \cdot 3}} = \sqrt[3]{3}$, kurse rrënja $\sqrt[12]{2^4}$ mund të thjeshtohet me 4 deri te rrënja $\sqrt[3]{2}$. ♦

Detyra 2. Rrënjët dhe $\sqrt[15]{a^{10}b^5}$ dhe $\sqrt[20]{a^{35}b^{10}}$ thjeshtojë treguesin më të madh të përbashkët të rrënjës, ku $a, b > 0$. ♦

Zgjidhje. Pasi PMP(15,20) = 5 rrënjët do t'i thjeshtojmë me 5 dhe kemi $\sqrt[15]{a^{10}b^5} = \sqrt[15 \cdot 5]{(a^2b)^{5 \cdot 5}} = \sqrt[75]{(a^2b)^{25}} = \sqrt[3]{a^2b}$ dhe $\sqrt[20]{a^{35}b^{10}} = \sqrt[20 \cdot 5]{(a^7b^2)^{5 \cdot 5}} = \sqrt[100]{(a^7b^2)^{25}} = \sqrt[4]{a^7b^2}$, përkatësisht. ♦

Shembulli 3. $\sqrt[9]{(-2)^{15}} = \sqrt[3]{(-2)^5}$, kurse $\sqrt[8]{(-2)^{12}} \neq \sqrt[4]{(-2)^3}$, pasi $\sqrt[4]{(-2)^3}$ nuk ka kuptim në bashkësinë e numrave realë, kurse $\sqrt[8]{(-2)^{12}} = \sqrt[2]{3}$. ♦

Prandaj, në situatat e këtilla, d.m.th., kur $a < 0$, n dhe k janë çift, kurse m numër natyror tek gjatë thjeshtimit të rrënjës gjithmonë duhet të kemi parasysh se rrënja pas thjeshtimit a ka kuptim në bashkësinë e numrave realë, përkatësisht duhet të shfrytëzojmë barazimin $\sqrt[n \cdot k]{a^{m \cdot k}} = \sqrt[n]{|a|^m}$.

Detyra

1. Rrënjët e dhëna zgjeroji me 3:

a) $\sqrt[5]{3^4}$, b) $\sqrt[3]{a^2b}$, për $a, b > 0$, c) $\sqrt[4]{(-2x)^2y^3}$, për $x, y > 0$.

2. Rrënjët e dhëna zgjeroji me 4:

a) $\sqrt[8]{16}$, b) $\sqrt[16]{a^{20}b^8}$, për $a, b > 0$, c) $\sqrt[4]{(-4x^{12})^{20}y^{16}}$ për $x, y > 0$.

3. Rrënjët e dhëna zgjeroji përkatësisht deri te shumëfishi më i vogël i përbashkët të treguesve të rrënjëve të tyre:

a) $\sqrt{2}$, $\sqrt[3]{3}$ dhe $\sqrt[4]{4}$, b) $\sqrt[6]{\frac{a^2b}{3}}$, $\sqrt[4]{\frac{ab^2}{4}}$ dhe $\sqrt[3]{2ab}$, për $a, b > 0$.

4. Rrënjët e dhëna zgjeroji me pjesëtuesin më të madh të përbashkët të treguesve të rrënjëve të tyre:

a) $\sqrt[3]{27a^6}$, $\sqrt[9]{8a^9b^3}$ dhe $\sqrt[6]{125b^9}$, për $a, b > 0$,
b) $\sqrt[6]{9a^4b^8}$, $\sqrt[8]{81a^6b^{12}}$ dhe $\sqrt[4]{a^{10}b^2}$, për $a, b > 0$.

5. Thjeshtoji rrënjët:

a) $\sqrt{\left(-\frac{1}{2}\right)^6}$, b) $\sqrt[4]{a^2}$, c) $\sqrt[6]{\frac{4a^2+4a+1}{0,04a^4b^2}}$, për $a, b \neq 0$.

1.3. Rrënjëzimi i prodhimit dhe herësit

Teorema. Nëse a dhe b janë numra realë pozitivë dhe n është numër natyror, atëherë $\sqrt[n]{a \cdot b} = \sqrt[n]{a} \cdot \sqrt[n]{b}$ dhe $\sqrt[n]{\frac{a}{b}} = \frac{\sqrt[n]{a}}{\sqrt[n]{b}}$.

Me të vërtetë, për fuqinë n të $\sqrt[n]{a} \cdot \sqrt[n]{b}$ kemi:

$$(\sqrt[n]{a} \cdot \sqrt[n]{b})^n = (\sqrt[n]{a})^n \cdot (\sqrt[n]{b})^n = a \cdot b,$$

kurse për fuqinë n të $\frac{\sqrt[n]{a}}{\sqrt[n]{b}}$ kemi: $\left(\frac{\sqrt[n]{a}}{\sqrt[n]{b}}\right)^n = \frac{(\sqrt[n]{a})^n}{(\sqrt[n]{b})^n} = \frac{a}{b}.$

Sipas përkufizimit për rrënjën kjo do të thotë se $\sqrt[n]{a \cdot b} = \sqrt[n]{a} \cdot \sqrt[n]{b}$ dhe $\sqrt[n]{\frac{a}{b}} = \frac{\sqrt[n]{a}}{\sqrt[n]{b}}$. ♦

Shembulli 1. $\sqrt{9 \cdot 4} = \sqrt{9} \cdot \sqrt{4} = 3 \cdot 2 = 6$, $\sqrt[3]{\frac{8}{27}} = \frac{\sqrt[3]{8}}{\sqrt[3]{27}} = \frac{2}{3}$. ♦

Duke pasur parasysh faktin se rrënja me tregues çift nuk ka kuptim në bashkësinë e numrave realë nëse shprehja nënrrënjë është numër negativ, gjithmonë kur $a < 0$, $b < 0$ dhe n është numër natyror, vlen $\sqrt[n]{a \cdot b} = \sqrt[n]{|a|} \cdot \sqrt[n]{|b|}$ dhe $\sqrt[n]{\frac{a}{b}} = \frac{\sqrt[n]{|a|}}{\sqrt[n]{|b|}}$.

Është e njohur se nëse n është numër natyror tek, $\sqrt[n]{a}$ ekziston për çdo numër real a , pra sipas kësaj barazimi prej teoremës shfrytëzohet pa vlerën absolute.

Të përfundojmë, barazimet $\sqrt[n]{a} \cdot \sqrt[n]{b} = \sqrt[n]{a \cdot b}$ dhe $\frac{\sqrt[n]{a}}{\sqrt[n]{b}} = \sqrt[n]{\frac{a}{b}}$, për a dhe b numra realë pozitivë, n është numër natyror, dhe $\sqrt[n]{a \cdot b} = \sqrt[n]{|a|} \cdot \sqrt[n]{|b|}$ dhe $\sqrt[n]{\frac{a}{b}} = \frac{\sqrt[n]{|a|}}{\sqrt[n]{|b|}}$, për a dhe b numra realë negativë dhe n është numër natyror çift, **quhen rregulla për shumëzimin dhe pjesëtimin e rrënjëve të cilat kanë tregues të njëjtë të rrënjës.**

Detyra 1. Thjeshtojë shprehjen:

a) $\sqrt[4]{16a^8}$, për $a \neq 0$, b) $\sqrt[5]{\frac{a^{35}}{-b^{10}}}$, për $b \neq 0$.

Zgjidhje. a) $\sqrt[4]{16a^8} = \sqrt[4]{2^4} \cdot \sqrt[4]{a^8} = 2 \cdot a^2$, b) $\sqrt[5]{\frac{a^{35}}{-b^{10}}} = \frac{\sqrt[5]{a^{35}}}{\sqrt[5]{-b^{10}}} = -\frac{a^7}{b^2}$. ♦

Shembulli 2. Vlera e $\sqrt{(-36) \cdot (-49)} = \sqrt{|36|} \cdot \sqrt{|-49|} = 6 \cdot 7 = 42$, kurse për $a < 0$ fitohet $\sqrt{-\frac{25}{16}a} = \sqrt{\left|-\frac{25}{16}\right|} \cdot \sqrt{|a|} = \frac{\sqrt{25}}{\sqrt{16}} \cdot \sqrt{|a|} = \frac{5}{4} \cdot \sqrt{|a|}$. ♦

Detyra 2. Njehso vlerën e shprehjes: **a)** $\sqrt[4]{81 \cdot (-1) \cdot (-x^8)}$

b) $\sqrt[3]{(-8) \cdot (-64) \cdot (-125)}$.

Zgjidhje. a) $\sqrt[4]{81 \cdot (-1) \cdot (-x^8)} = \sqrt[4]{81} \cdot \sqrt[4]{|-1|} \cdot \sqrt[4]{|-x^8|} = 3 \cdot 1 \cdot x^2 = 3x^2$,

b) $\sqrt[3]{(-8) \cdot (-64) \cdot (-125)} = \sqrt[3]{-8} \cdot \sqrt[3]{-64} \cdot \sqrt[3]{-125} = -2 \cdot (-4) \cdot (-5) = -40$. ♦

Detyra 3. Për cilat vlera të ndryshores x vlejné këto barazime?

a) $\sqrt{x \cdot (x+1)} = \sqrt{x} \cdot \sqrt{x+1}$, **b)** $\sqrt{x \cdot (x^2+1)} = \sqrt{x} \cdot \sqrt{x^2+1}$,

c) $\sqrt[3]{x \cdot (x^2+2)} = \sqrt[3]{x} \cdot \sqrt[3]{x^2+2}$.

Zgjidhje. a) Patjetër të gjitha rrënjët të kenë kuptim në bashkësinë e numrave realë, Prandaj, e kërkojmë prerjen prej intervaleve të cilat janë zgjidhje të pabarazimeve $x > 0$, $x+1$ dhe $x \cdot (x+1) > 0$ d.m.th., $x > 0$,

b) Pasi $x^2+1 > 0$ për çdo vlerë të $x \in \mathbb{R}$, patjetër $x > 0$,

c) Për çdo vlerë të ndryshores x . ♦

Detyra 4. Njehso vlerën e shprehjes:

a) $\sqrt[4]{\left(2-\frac{1}{2}\right)^2} \cdot \sqrt[4]{1-\frac{1}{2}} \cdot \sqrt[4]{5-\frac{1}{2}}$, **b)** $\sqrt[4]{12a^5} : \sqrt[4]{3a^2}$, për $a > 0$.

Zgjidhje. Sipas teoremës kemi:

a) $\sqrt[4]{\left(2-\frac{1}{2}\right)^2} \cdot \sqrt[4]{1-\frac{1}{2}} \cdot \sqrt[4]{5-\frac{1}{2}} = \sqrt[4]{\left(2-\frac{1}{2}\right)^2 \cdot \left(1-\frac{1}{2}\right) \cdot \left(5-\frac{1}{2}\right)} =$
 $= \sqrt[4]{\left(\frac{3}{2}\right)^2 \cdot \frac{1}{2} \cdot \frac{9}{2}} = \sqrt[4]{\frac{3^4}{2^4}} = \frac{\sqrt[4]{3^4}}{\sqrt[4]{2^4}} = \frac{3}{2}$,

b) $\sqrt[4]{12a^5} : \sqrt[4]{3a^2} = \sqrt[4]{\frac{12a^5}{3a^2}} = \sqrt[4]{4a^3}$, për $a > 0$. ♦

Shembulli 3. Prodhimi $\sqrt[3]{2} \cdot \sqrt{2}$ mund të njehsohet vetëm nëse rrënjët kanë tregues të njëjtë të rrënjës, pra përkatësisht i zgjerojmë deri te shumëfishi më i vogël i përbashkët të treguesve të rrënjëve, d.m.th., numri 6. Në këtë mënyrë prodhimi transformohejt deri $\sqrt[3]{2} \cdot \sqrt{2} = \sqrt[6]{2^2} \cdot \sqrt[6]{2^3} = \sqrt[6]{2^5}$. ♦

Detyra

1. Njehso:

a) $\sqrt{16 \cdot 25 \cdot 64}$, **b)** $\sqrt[3]{1000 \cdot a^3}$,

c) $\sqrt{\frac{0,01}{441}}$, **ç)** $\sqrt[5]{\frac{32a^{15}}{b^{20}c^{10}}}$, për $b, c \neq 0$.

2. Njehso:

a) $\sqrt{a^3b^2} \cdot \sqrt{a^7b^5c^4}$, për $a, b, c > 0$, **b)** $\sqrt[3]{a} \cdot \sqrt[3]{6a^2} \cdot \sqrt[3]{4} \cdot \sqrt[3]{3}$.

c) $\sqrt[5]{4a^2b^3} : \sqrt[5]{2ab}$ për $a, b \neq 0$, **ç)** $\sqrt[4]{32a^5b^3} : \sqrt[4]{2a^4b^5}$ për $a, b > 0$.

3. Njehso:

a) $\sqrt{64 \cdot (-25) \cdot (-36)}$,

b) $\sqrt[4]{\frac{-81}{x}}$, për $x < 0$,

c) $\sqrt[5]{\frac{-32x^5y^{15}}{z^{20}}}$, për $z \neq 0$,

d) $\sqrt{\frac{(x-1)^4}{x(x^2+1)^2}}$, për $x > 0$.

4. Njehso:

a) $\sqrt[3]{2x^2} \cdot \sqrt[4]{3x^2y}$, për $x, y > 0$,

b) $\sqrt[3]{4x^2y} : \sqrt[6]{2xy^3}$, për $x, y > 0$.

5. Cakto për cilën vlerë të ndryshores x vlejné barazimet:

a) $\sqrt{(x+1)^2} = x+1$

b) $\sqrt{x^2(x-1)^2} = x \cdot (x-1)$

1.4. Nxjerrja e shumëzuesit para shenjës së rrënjës, futja e shumëzuesit nën shenjën e rrënjës dhe forma normale e rrënjës

Nëse te rrënja $\sqrt[n]{A}$, shprehja nën rrënjë A mund të shkruhet në formën $a^{m \cdot n} \cdot b$, ku, $a, b > 0$, kurse m dhe n janë numra natyrorë, atëherë mund të zbatohen teoremat për rrënjëzim të prodhimit $\sqrt[n]{a^{m \cdot n}} \cdot \sqrt[n]{b}$ dhe thjeshtim të rrënjës së dhënë $a^m \cdot \sqrt[n]{b}$. Transformimi të cilin e kryejmë në këtë mënyrë quhet **nxjerrja e shumëzuesit para shenjës së rrënjës**.

Për fuqinë n të $a^m \cdot \sqrt[n]{b}$ kemi:

$$(a^m \cdot \sqrt[n]{b})^n = (a^m)^n \cdot (\sqrt[n]{b})^n = a^{m \cdot n} \cdot b.$$

Sipas përkufizimit për rrënjë vlen $\sqrt[n]{a^{m \cdot n} \cdot b} = a^m \cdot \sqrt[n]{b}$ sipas kësaj vlen kjo teoremë:

Teorema. Nëse a dhe b janë numra realë pozitivë, kurse n dhe m janë numra natyrorë, atëherë vlen $\sqrt[n]{a^{m \cdot n} \cdot b} = a^m \cdot \sqrt[n]{b}$.

Posaçërisht, nëse $m = 1$, atëherë $\sqrt[n]{a^n \cdot b} = a \cdot \sqrt[n]{b}$.

Shembulli 1. Le të jetë $a, b, c > 0$. Atëherë

a) $\sqrt[3]{8a^4b^3c^2} = \sqrt[3]{2^3 \cdot a^3 \cdot a \cdot b^3 \cdot c^2} = \sqrt[3]{2^3} \cdot \sqrt[3]{a^3} \cdot \sqrt[3]{a} \cdot \sqrt[3]{b^3} \cdot \sqrt[3]{c^2} = 2ab^3\sqrt[3]{ac^2}$ dhe themi se $2ab$ është shumëzues i cili është nxjerrë para shenjës së rrënjës $\sqrt[3]{ac^2}$,

b) $\sqrt{28a^3b^5} = \sqrt{2^2 \cdot 7 \cdot a^2 \cdot a \cdot b^{2 \cdot 2} \cdot b} = \sqrt{2^2} \cdot \sqrt{7} \cdot \sqrt{a^2} \cdot \sqrt{a} \cdot \sqrt{b^{2 \cdot 2}} \cdot \sqrt{b} = 2ab^2\sqrt{7ab}$ dhe themi se $2ab^2$ është shumëzues i cili është nxjerrë para shenjës së rrënjës $\sqrt{7ab}$,

c) $\sqrt[3]{\frac{a^3b^4}{125c^6}} = \frac{\sqrt[3]{a^3} \cdot \sqrt[3]{b^3} \cdot \sqrt[3]{b}}{\sqrt[3]{5^3 \cdot \sqrt[3]{c^{2 \cdot 3}}}} = \frac{ab^3\sqrt[3]{b}}{5c^2}$ dhe themi se $\frac{ab}{5c^2}$ është shumëzues i cili është nxjerrë para shenjës së rrënjës $\sqrt[3]{b}$,

d) $\sqrt[4]{48 \cdot (x-1)^4} = \sqrt[4]{2^4 \cdot 3 \cdot (x-1)^4} = \sqrt[4]{2^4} \cdot \sqrt[4]{3} \cdot \sqrt[4]{(x-1)^4} = 2|x-1|\sqrt[4]{3}$ dhe themi se $2|x-1|$ është shumëzues i cili është nxjerrë para shenjës së rrënjës $\sqrt[4]{3}$. ♦

Gjatë zgjidhje së disa detyrave paraqitet nevoja shumëzuesin, i cili gjendet para shenjës së rrënjës, ta futim nën shenjën e rrënjës. Për këtë qëllim atë shumëzues e fuqizojmë me treguesin e rrënjës dhe shprehjen e fituar pastaj e shumëzojmë me madhësinë nënrrënjësore. Ky transformim quhet **futja e shumëzuesit nën shenjën e rrënjës** dhe vlen kjo teoremë:

Teorema. Nëse a dhe b janë numra realë pozitivë, kurse n dhe m janë numra natyrorë, atëherë vlen $a^m \cdot \sqrt[n]{b} = \sqrt[n]{a^{m \cdot n} \cdot b}$.

Shembulli 2. a) $3\sqrt{3} = \sqrt{3^2 \cdot 3} = \sqrt{27}$,

b) $a^3\sqrt{a^2} = \sqrt[3]{a^3 \cdot a^2} = \sqrt[3]{a^5}$,

c) $ab\sqrt{\frac{1}{a} + \frac{1}{b}} = \sqrt{(ab)^2 \cdot \left(\frac{1}{a} + \frac{1}{b}\right)} = \sqrt{(ab)^2 \cdot \frac{a+b}{ab}} = \sqrt{ab(a+b)}$, për $a, b > 0$,

ç) $\frac{1}{x^2} \sqrt[4]{\frac{1}{x}} = \sqrt[4]{\left(\frac{1}{x^2}\right)^4 \cdot \frac{1}{x}} = \sqrt[4]{\frac{1}{x^9}}$, për $x > 0$. ♦

Përkufizimi. Për rrënjën e dhënë themi se është në **formën normale**, nëse shprehja nën rrënjë nuk përmban emërues dhe shumëzues të cilët mund të nxirren para shenjës së rrënjës, dhe ka tregues më të vogël të mundshëm të rrënjës.

Shembulli 3. Te forma normale janë rrënjët $\sqrt{6}$, $3a^3\sqrt{2a^2}$ dhe $\sqrt[4]{4a^3}$, për $a > 0$, kurse nuk janë në formën normale këto rrënjë, $\sqrt{\frac{2}{3}}$, $\sqrt[9]{8a^6}$ dhe $\sqrt[4]{16x}$, për $x > 0$.

Shembulli 4. a) $2a\sqrt{\frac{3}{a}} = 2a\sqrt{\frac{3}{a} \cdot \frac{a}{a}} = 2a\sqrt{\frac{3a}{a^2}} = 2a \cdot \frac{1}{a}\sqrt{3a} = 2\sqrt{3a}$, për $a > 0$,

b) $\sqrt[4]{\frac{4a^2b^4}{(a^2-1)^2}} = \sqrt[4]{\frac{2^2a^2b^4}{(a^2-1)^2}} = \sqrt{\frac{2ab^2}{(a^2-1)} \cdot \frac{(a^2-1)}{(a^2-1)}} = \frac{b}{a^2-1}\sqrt{2a(a^2-1)}$ për $a > 1$ dhe $b > 0$,

c) $\sqrt{\frac{1}{a+1} + \frac{1}{a^2+1}} = \sqrt{\frac{a-1}{a^2-1} + \frac{1}{a^2-1}} = \sqrt{\frac{a-1+1}{a^2-1}} = \sqrt{\frac{a}{a^2-1} \cdot \frac{a^2}{a^2-1}} = \frac{1}{a^2-1}\sqrt{a(a^2-1)}$, për $a > 1$,

ç) $\frac{b}{a}\sqrt[3]{\frac{a^4-a^3}{b^4-b^3}} = \frac{b}{a}\sqrt[3]{\frac{a^3(a-1)}{b^3(b-1)}} = \frac{b}{a} \cdot \frac{a}{b}\sqrt[3]{\frac{a-1}{b-1} \cdot \frac{(b-1)^2}{(b-1)^2}} = \frac{1}{b-1}\sqrt[3]{(a-1)(b-1)^2}$ për $a \neq 0$, $b \neq 0$ dhe $b \neq 1$ ♦

Kur një rrënjë është shkruar në formën normale, shumëzuesi racional para shenjës së rrënjës quhet **koeficient** para rrënjës. Poashtu, dy ose më shumë rrënjë të shkruara në formën normale janë **të ngjashme** nëse kanë koeficient të ndryshëm, d.m.th., kanë treguesin e njëjtë të rrënjës dhe shprehjen nën rrënjë të njëjtë.

Detyra 1. Cilat prej këtyre rrënjëve janë të ngjashme?

a) $\sqrt{3}$ dhe $\sqrt{12}$, **b)** $\sqrt{\frac{a}{2}}$ dhe $\sqrt{\frac{2}{a}}$, për $a > 0$,

c) $\sqrt{\frac{3}{8}}$, $\sqrt{45}$ dhe $\sqrt{216}$, c) $\sqrt{2\frac{1}{4}}$, $\sqrt{60}$ dhe $\sqrt{\frac{1}{15}}$.

Zgjidhje. Së pari të gjitha rrënjët i shkruajmë në formën normale, kurse pastaj kontrollojmë a janë të ngjashëm.

a) $\sqrt{12} = \sqrt{2^2 \cdot 3} = 2\sqrt{3}$, pra $\sqrt{3}$ dhe $\sqrt{12} = 2\sqrt{3}$ janë të ngjashëm pasi dallohen vetëm te koeficientët para shenjës së rrënjës, d.m.th., koeficienti i $\sqrt{3}$ është 1, kurse koeficienti i $2\sqrt{3}$ është 2,

b) $\sqrt{\frac{a}{2}} = \sqrt{\frac{a}{2} \cdot \frac{2}{2}} = \frac{\sqrt{2a}}{2}$ dhe $\sqrt{\frac{2}{a}} = \sqrt{\frac{2}{a} \cdot \frac{a}{a}} = \frac{\sqrt{2a}}{2}$ janë të ngjashëm pasi $\frac{\sqrt{2a}}{2}$ ka koeficient $\frac{1}{2}$, kurse $\frac{\sqrt{2a}}{2}$ ka koeficient $\frac{1}{a}$,

c) $\sqrt{\frac{3}{8}} = \sqrt{\frac{3}{8} \cdot \frac{2}{2}} = \frac{\sqrt{6}}{4}$, $\sqrt{216} = \sqrt{4 \cdot 9 \cdot 6}$ dhe $\sqrt{45} = \sqrt{3^2 \cdot 5} = 3\sqrt{5}$. Nuk janë të ngjashëm pasi $3\sqrt{5}$. Nuk ka shprehje nënrrënjësore të njëjtë me dy rrënjët e tjera,

c) $\sqrt{2\frac{1}{4} \cdot 15} = \sqrt{\frac{9}{4} \cdot 15} = \frac{3}{2}\sqrt{15}$, $\sqrt{60} = \sqrt{4 \cdot 15} = 2\sqrt{15}$ dhe $\sqrt{\frac{1}{15}} = \sqrt{\frac{1}{15} \cdot \frac{15}{15}} = \frac{\sqrt{15}}{15}$ janë të ngjashme. ♦

Detyra

1. Nxirre shumëzuesin para shenjës së rrënjës:

a) $\sqrt{50}$, b) $\sqrt[3]{0,024}$, c) $\sqrt[4]{\frac{2x^5}{y^6}}$, për $x, y > 0$, c) $\sqrt[5]{\frac{64a^8}{81b^{13}}}$, $b \neq 0$

2. Fute shumëzuesin nën shenjën e rrënjës:

a) $2 \cdot \sqrt[3]{\frac{1}{2} - \frac{1}{7}}$, b) $3ab^2 \sqrt{\frac{12}{ab}}$ për $a, b > 0$,

c) $\frac{a+1}{a} \sqrt{\frac{a^4 - a^3}{a+1}}$, për $a > 0$, c) $\frac{2x^2}{3} \sqrt[4]{\frac{27a^2}{4x^2}}$, për $x \neq 0$.

3. Rrënjët e dhëna shkruaji në formën normale:

a) $\frac{x-y}{x} \sqrt{\frac{1}{xy-y^2}}$, për $x > y > 0$, b) $\frac{2bc}{3xy} \sqrt{\frac{9x^3y^4}{8bc}}$, për $x, y, b, c > 0$,

c) $\sqrt[3]{\frac{a}{a^2-2ab+b^2}}$, për $a \neq b$, c) $\sqrt[5]{\frac{32}{a^3}}$, për $a \neq 0$.

4. Cilat prej këtyre rrënjëve janë të ngjashëm, për $a, b > 0$?

a) $\sqrt[4]{9a^2b^4}$ dhe $\sqrt[6]{27a^3b^6}$, b) $\sqrt{50ab^2}$ dhe $\sqrt{120a^3}$,

c) $\sqrt[3]{\frac{27b}{a^2}}$ dhe $\sqrt[3]{\frac{a}{b^2}}$.

5. Vërteto se janë rrënjë të ngjashme $\frac{3}{a}\sqrt{a^3b}$, $\frac{2}{a}\sqrt{ab^5}$ dhe $ab\sqrt{\frac{1}{a^3b}}$, për $a, b > 0$.

1.5. Operacionet me rrënjë

Mbledhja dhe zbritja e rrënjëve

Mblidhen, përkatësisht zbriten vetëm rrënjët e ngjashme. Poashtu operacioni përkatës (mbledhja ose zbritja) kryhet me koeficientët e tyre.

Shembulli 1. a) $2\sqrt{3} + 5\sqrt{3} = (2 + 5) \cdot \sqrt{3} = 7\sqrt{3}$,

b) $(3\sqrt[3]{a} + 5\sqrt[3]{8a} - 11\sqrt[3]{27a}) = 3\sqrt[3]{a} + 5\sqrt[3]{2^3a} - 11\sqrt[3]{3^3a} =$
 $= 3\sqrt[3]{a} + 10\sqrt[3]{a} - 33\sqrt[3]{a} = (3 + 10 - 33) \cdot \sqrt[3]{a}$, për $a > 0$,

c) $2\sqrt{a^3} + \frac{3}{a}\sqrt{a^5} - \frac{3}{b}\sqrt{b^3} + \sqrt{b} = 2a\sqrt{a} + 3a\sqrt{a} - 3\sqrt{b} + \sqrt{b} =$
 $= (2a + 3a)\sqrt{a} + (-3 + 1)\sqrt{b} = 5a\sqrt{a} - 2\sqrt{b}$, për $a, b > 0$

ç) $2a^3\sqrt[4]{a^4b} - 3a^3\sqrt[4]{ab^4} - a^2\sqrt[4]{\frac{b^4}{a^2}} + 2b^3\sqrt[4]{\frac{a}{b^2}} = 2a^3\sqrt[4]{a^3 \cdot a \cdot b} - 3a^3\sqrt[4]{a \cdot b^3 \cdot b} - a^2\sqrt[4]{\frac{b^3 \cdot b}{a^2} \cdot \frac{a}{a}} + 2b^3\sqrt[4]{\frac{a}{b^2} \cdot \frac{b}{b}} =$
 $= 2a^2\sqrt[4]{ab} - 3ab\sqrt[4]{ab} - ab\sqrt[4]{ab} + \sqrt[4]{ab} =$
 $= (2a^2 - 3ab - ab + b^2)\sqrt[4]{ab} = (2a^2 - 4ab + ab^2)\sqrt[4]{ab} = 2(a - b)^2\sqrt[4]{ab}$, për $a, b > 0$. ♦

Shumëzimi dhe pjesëtimi i rrënjëve

Shumëzohen, përkatësisht pjesëtohen rrënjët të cilat kanë tregues të njëjtë të rrënjës. Poashtu operacioni përkatës (shumëzim ose pjesëtim) realizohen me shprehjet nënrrënjësore të tyre dhe prodhimi përkatësisht herësi ka tregues të njëjtë të rrënjës.

Shembulli 2. a) $\sqrt[3]{5} \cdot \sqrt[3]{2} = \sqrt[3]{5 \cdot 2} = \sqrt[3]{10}$

b) $\sqrt{a} \cdot \sqrt[6]{a} = \sqrt[6]{a^3} \cdot \sqrt[6]{a^2} = \sqrt[6]{a^3 \cdot a^2} = \sqrt[6]{a^5}$, për $a > 0$,

c) $(\sqrt[5]{8} : \sqrt[3]{2}) = \sqrt[15]{8^3} : \sqrt[15]{2^5} = \sqrt[15]{\frac{(2^3)^3}{2^5}} = \sqrt[15]{2^4}$

ç) $\sqrt[4]{\frac{2a^3}{b^3}} : \sqrt[6]{\frac{2a}{b}} = \sqrt[12]{\left(\frac{2a^3}{b^3}\right)^3} : \sqrt[12]{\left(\frac{2a}{b}\right)^2} = \sqrt[12]{\frac{8a^9}{b^9} : \frac{4a^2}{b^2}} =$
 $= \sqrt[12]{\frac{8a^9}{b^9} \cdot \frac{b^2}{4a^2}} = \sqrt[12]{\frac{2a^7}{b^7} \cdot \frac{b^5}{b^5}} = \frac{1}{b} \sqrt[12]{2a^7b^5}$, për $a, b > 0$.

Fuqizimi dhe rrënjësimi i rrënjës

Teorema vijuese i cakton rregullat për fuqizim dhe rrënjëzim të rrënjës.

Teorema. Nëse a është numër real pozitiv, kurse m dhe n janë numra natyrorë, atëherë vlejné barazimet: $(\sqrt[n]{a})^m = \sqrt[n]{a^m}$ dhe $\sqrt[n]{\sqrt[m]{a}} = \sqrt[n \cdot m]{a}$.

Me të vërtetë, për n fuqia e $(\sqrt[n]{a})^m$ kemi:

$$\left((\sqrt[n]{a})^m\right)^n = (\sqrt[n]{a})^{n \cdot m} = \left((\sqrt[n]{a})^n\right)^m = a^m.$$

Prej përkufizimit për rrënjë kemi se $\sqrt[n]{a^m} = (\sqrt[n]{a})^m$.

Ngjashëm, për nm fuqia e $\sqrt[n]{m}\sqrt{a}$ kemi:

$$\left(\sqrt[n]{m}\sqrt{a}\right)^{n \cdot m} = \left(\left(\sqrt[n]{m}\sqrt{a}\right)^n\right)^m = \left(\sqrt{a}\right)^m = a$$

Prej përkufizimit për rrënjë kemi se $\sqrt[n]{m}\sqrt{a} = \sqrt[n]{m}\sqrt{a} \cdot \diamond$

Barazimin $\left(\sqrt[n]{a}\right)^m = \sqrt[n]{a^m}$ e quajmë rregull për fuqizim të rrënjës, kurse $\sqrt[n]{m}\sqrt{a} = \sqrt[n]{m}\sqrt{a}$ rregull për rrënjëzim të rrënjës.

Shembulli 3.

a) $(\sqrt[3]{2})^4 = \sqrt[3]{16} = 2\sqrt[3]{2},$

b) $(\sqrt{a^3b})^3 = \sqrt{a^9b^3} = a^3b\sqrt{ab},$ për $a, b > 0,$

c) $\sqrt[3]{\sqrt{5}} = \sqrt[6]{5},$

ç) $\sqrt{2\sqrt{2}} = \sqrt{2} \cdot \sqrt{\sqrt{2}} = \sqrt{\sqrt{2^2} \cdot 2} = \sqrt[4]{8},$

d) $\sqrt[3]{5x\sqrt{xy}} = \sqrt[3]{5x} \cdot \sqrt[3]{\sqrt{xy}} = \sqrt[6]{25x^2} \cdot \sqrt[6]{xy} = \sqrt[6]{25x^3y},$ për $x, y > 0. \diamond$

Detyra 1. Kryeji operacionet e shënuara:

a) $16\sqrt{2x} \cdot \frac{1}{4}\sqrt[3]{4x},$ për $x > 0,$

b) $\left(\sqrt[a]{\frac{1}{2}} + \sqrt{2a} + 2\sqrt{\frac{a}{2}} - \sqrt{\frac{2}{a}}\right) \cdot \sqrt{2a},$ për $a > 0$

c) $(\sqrt[4]{8a^6b^9} - ab\sqrt[6]{8a^4b^5} + ab^2\sqrt[4]{2a^{4b}}) : \sqrt[4]{2ab},$ për $a, b > 0$

ç) $\sqrt[3]{\sqrt{a^2} \cdot \sqrt[3]{a^4}} : \sqrt[3]{a\sqrt{a} \cdot \sqrt[3]{a^2}},$ për $a > 0.$

Zgjidhje. a) $16\sqrt{2x} \cdot \frac{1}{4}\sqrt[3]{4x} = 16 \cdot \frac{1}{4} \cdot \sqrt[6]{(2x)^3} \cdot \sqrt[6]{(4x)^2} = 4\sqrt[6]{2^3 \cdot x^3 \cdot 2^4 \cdot x^2} =$
 $= 4 \cdot 2 \cdot \sqrt[6]{2x^5} = 8\sqrt[6]{2x^5},$

b) $\left(\sqrt[a]{\frac{1}{2}} + \sqrt{2a} + 2\sqrt{\frac{a}{2}} - \sqrt{\frac{2}{a}}\right) \cdot \sqrt{2a} =$
 $= a\sqrt{\frac{1}{2} \cdot 2a} + \sqrt{2a \cdot 2a} + 2\sqrt{\frac{a}{2} \cdot 2a} - \sqrt{\frac{2}{a} \cdot 2a} =$
 $= a\sqrt{a} + 2a + 2a - 2 = a\sqrt{a} + 4a - 2,$

c) $(\sqrt[4]{8a^6b^9} - ab\sqrt[6]{8a^4b^5} + ab^2\sqrt[4]{2a^{4b}}) : \sqrt[4]{2ab} =$
 $= \sqrt[4]{\frac{8a^6b^9}{2ab}} - ab\sqrt[12]{\frac{(8a^4b^5)^2}{(ab)^3}} + ab^2\sqrt[4]{\frac{2a^{4b}}{2ab}} =$
 $= \sqrt[4]{4a^5b^8} - ab\sqrt[12]{8a^5b^7} + ab^2\sqrt[4]{a^3} = ab^2\sqrt{2} - ab\sqrt[12]{8a^5b^7} + ab^2\sqrt[4]{a^3},$

ç) $\sqrt[3]{\sqrt{a^2} \cdot \sqrt[3]{a^4}} : \sqrt[3]{a\sqrt{a} \cdot \sqrt[3]{a^2}} = (\sqrt[3]{\sqrt{a^2}} \cdot \sqrt[3]{\sqrt[3]{a^4}}) : (\sqrt[3]{a} \cdot \sqrt[3]{\sqrt{a}} \cdot \sqrt[3]{\sqrt[3]{a^2}}) =$
 $= (\sqrt[6]{a^2} \cdot \sqrt[6]{a^4}) : (\sqrt[3]{a} \cdot \sqrt[6]{a} \cdot \sqrt[9]{a^2}) = \sqrt[18]{\frac{(a^2)^3 \cdot (a^4)^3}{a^6 \cdot a^3 \cdot (a^2)^2}} \cdot \diamond$

Detyra

1. Njehso:

$$\begin{array}{lll} \text{a)} (\sqrt{2} + \sqrt{3})^2, & \text{b)} (1 - \sqrt{a})^2 \text{ për } a > 0, & \text{c)} (1 - 2\sqrt{3})^2, \\ \text{ç)} \sqrt{2\sqrt{2\sqrt{2}}}, & \text{d)} \sqrt[4]{a^3 \sqrt[3]{a^2 \sqrt{a}}}, \text{ për } a > 0. \end{array}$$

2. Njehso:

$$\begin{array}{l} \text{a)} 3a^4 \sqrt[4]{a^3} \cdot 2a^2 \sqrt[4]{a}, \text{ për } a > 0, \\ \text{b)} \sqrt[3]{ab^2} \cdot \sqrt[4]{a^3 bc^2}, \text{ për } a, b, c > 0, \\ \text{c)} } 6a^4 \sqrt{a^2 - b^2} : (-3a^4 \sqrt{a + b}), \text{ për } a > 0, |b| < a \\ \text{ç)} \sqrt[3]{a^2 b^5 c^4} : \sqrt{ab^2 c^2}, \text{ për } a, b, c > 0. \end{array}$$

3. Njehso:

$$\begin{array}{l} \text{a)} 3\sqrt{2} + 5\sqrt{8} - \sqrt{128} + \sqrt{32}, \\ \text{b)} } a\sqrt{\frac{1}{a}} + 2\sqrt{a} - 5\sqrt{\frac{a+1}{a-1}} + (a+1)\sqrt{\frac{1}{a^2-1}}, \text{ për } a > 1, \end{array}$$

4. Kryeji operacionet e shënuara:

$$\begin{array}{ll} \text{a)} \sqrt[3]{\frac{12}{25} \sqrt{\frac{244}{15(38^2 - 23^2)}}}, & \text{b)} \sqrt{a^6 \sqrt{a^5}} + \sqrt[4]{a^3 \sqrt[3]{a^2}} - 2\sqrt[3]{a^2 \sqrt[4]{a^3}} \end{array}$$

$$5. \text{ Njehso: } \sqrt{a^5} \cdot \sqrt[3]{a^2} : (\sqrt[4]{a^7} \cdot \sqrt[12]{a^{11}}), \text{ për } a > 0.$$

1.6. Racionalizimi i emëruesit të thyesës

Në praktikë shpesh hasen shprehje të cilat te emëruesi përmbajnë të paktën një rrënjë. Mënyra me të cilën shprehjet e këtilla i shkruajmë me shprehje të cilat janë identike me ato dhe poashtu nuk përmbajnë rrënjë te emëruesi quhet **racionalizimi i emëruesit të thyesës**.

Për të realizuar atë mënyra duhet emëruesin e thyesës ta zgjerojmë me shprehje të atillë ashtu që shprehja e re, te emëruesi, nuk do të përmbajë rrënjë.

Nëse thyesa ka emërues $\sqrt[n]{A^m}$, ku $m < n$, atëherë e zgjerojmë me $\sqrt[n]{A^{n-m}}$, pasi prodhimi $\sqrt[n]{A^m} \cdot \sqrt[n]{A^{n-m}} = A$ nuk përmban rrënjë.

Shembulli 1. a) $\frac{5}{\sqrt{2}}$ do ta racionalizojmë nëse thyesën e zgjerojmë me $\sqrt{2^{2-1}} = \sqrt{2}$, pra

$$\text{kemi: } \frac{5}{\sqrt{2}} = \frac{5}{\sqrt{2}} \cdot \frac{\sqrt{2}}{\sqrt{2}} = \frac{5\sqrt{2}}{\sqrt{2^2}} = \frac{5\sqrt{2}}{2},$$

$$\text{b)} \frac{1}{\sqrt[3]{5}} \text{ do ta zgjerojmë me } \sqrt[3]{5^{3-1}} = \sqrt[3]{5^2} \text{ dhe kemi: } \frac{1}{\sqrt[3]{5}} = \frac{1}{\sqrt[3]{5}} \cdot \frac{\sqrt[3]{5^2}}{\sqrt[3]{5^2}} = \frac{\sqrt[3]{5^2}}{5}$$

$$\text{c)} \frac{3}{\sqrt[5]{a^{11}}} \text{ së pari do ta nxjerrim shumëzuesin para shenjës së rrënjës, d.m.th., } \frac{3}{a^2 \sqrt[5]{a}}, \text{ kurse}$$

pastaj do ta zgjerojmë thyesën me $\sqrt[5]{a^4}$, pra kemi: $\frac{3}{a^2\sqrt[5]{a}} = \frac{3}{a^2\sqrt[5]{a}} \cdot \frac{\sqrt[5]{a^4}}{\sqrt[5]{a^4}} = \frac{3\sqrt[5]{a^4}}{a^3}$, për $a > 0$. ♦

Nëse thyesa ka emërues të llojit $\sqrt{A} + \sqrt{B}$, $\sqrt{A} - \sqrt{B}$, $A + \sqrt{B}$ ose $A - \sqrt{B}$, atëherë e zgjerojmë me $\sqrt{A} - \sqrt{B}$, $\sqrt{A} + \sqrt{B}$, $A - \sqrt{B}$, $A + \sqrt{B}$ përkatësisht, për ta shfrytëzuar formulën $(a+b)(a-b) = a^2 - b^2$.

Shembulli 2. a) thyesën $\frac{5}{\sqrt{3}+\sqrt{2}}$ do ta zgjerojmë me $\sqrt{3} - \sqrt{2}$, pra kemi:

$\frac{5}{\sqrt{3}+\sqrt{2}} = \frac{5}{\sqrt{3}+\sqrt{2}} \cdot \frac{\sqrt{3}-\sqrt{2}}{\sqrt{3}-\sqrt{2}} = \frac{5(\sqrt{3}-\sqrt{2})}{(\sqrt{3}+\sqrt{2})(\sqrt{3}-\sqrt{2})}$. Te prodhimi i emëruesit mund ta shfrytëzojmë formulën $(a+b)(a-b) = a^2 - b^2$, pra kemi:

$$\frac{5(\sqrt{3}-\sqrt{2})}{(\sqrt{3}+\sqrt{2})(\sqrt{3}-\sqrt{2})} = \frac{5(\sqrt{3}-\sqrt{2})}{\sqrt{3^2}-\sqrt{2^2}} = \frac{5(\sqrt{3}-\sqrt{2})}{3-2} = 5(\sqrt{3}-\sqrt{2}),$$

$$\text{b)} \frac{2x-4y}{\sqrt{x}-\sqrt{2y}} = \frac{2x-4y}{\sqrt{x}-\sqrt{2y}} \cdot \frac{\sqrt{x}+\sqrt{2y}}{\sqrt{x}+\sqrt{2y}} = \frac{(2x-4y)(\sqrt{x}+\sqrt{2y})}{\sqrt{x^2}-\sqrt{(2y)^2}} =$$

te emëruesi fitohet shprehja e cila mund të thjeshtohet me numëruesin, pra kemi:

$$= \frac{2(x-2y)(\sqrt{x}+\sqrt{2y})}{x-2y} = 2(\sqrt{x} + \sqrt{2y}), \text{ për } x, y > 0 \text{ dhe } x \neq -2y. \text{ ♦}$$

Kjo do të thotë se nëse te emëruesi i thyesës kemi shprehje $\sqrt{A} + \sqrt{B}$, atëherë së pari mund ta zgjerojmë me $\sqrt{A} + \sqrt{B}$, kurse pastaj me $A - \sqrt{B}$, por mund të punojmë edhe në këtë mënyrë: së pari ta zgjerojmë me $\sqrt{A} - \sqrt{B}$, kurse pastaj me $\sqrt{A^2 - B}$. Në mënyrë analoge realizohet edhe për thyesën me emërues $\sqrt{A} - \sqrt{B}$.

Detyra

1. Racionalizo emëruesin e thyesës:

a) $\frac{2}{\sqrt[3]{12}}$,

b) $\frac{23}{5-\sqrt{2}}$,

c) $\frac{xy}{x\sqrt{y}-y\sqrt{x}}$, për $x, y > 0$ dhe $x \neq y$,

ç) $\frac{a}{\sqrt[5]{a^3}}$, për $a > 0$,

d) $\frac{\sqrt{11}-\sqrt{7}}{\sqrt{11}+\sqrt{7}}$,

dh) $\frac{5}{3-2\sqrt{2}}$,

e) $\frac{a^2-4b^2}{\sqrt{a}+\sqrt{2b}}$ për $a, b > 0$,

1.7. Fuqia me tregues numër racional

Përkufizimi. Nëse a është numër real pozitiv $\frac{m}{n}$ është numër racional ku m është numër i plotë, kurse n numër natyror, atëherë $a^{\frac{m}{n}} = \sqrt[n]{a^m}$ quhet **fuqi me tregues numër racional**.

Posaçërisht, nëse $m = 1$, atëherë $a^{\frac{1}{n}} = \sqrt[n]{a}$.

Nëse i kemi parasysh operacionet me fuqi, atëherë vlejné barazimet:

$$a^{\frac{m}{n}} = \left(a^{\frac{1}{n}}\right)^m = \left(a^m\right)^{\frac{1}{n}}.$$

Shembulli 1. $2^{\frac{1}{2}} = \sqrt{2}$, $8^{-\frac{3}{5}} = \sqrt[5]{8^{-3}}$, $64^{\frac{2}{3}} = \sqrt[3]{64^2}$ janë shembuj të disa fuqive të shkruara si rrënjë. ♦

Shembulli 2. $(\sqrt{100} = 100^{\frac{1}{2}}$, $\sqrt[3]{(8a)^4} = (8a)^{\frac{4}{3}}$, $\sqrt[5]{9x^2} = (3x)^{\frac{2}{5}}$ janë shembuj të disa rrënjëve të shkruara si fuqi. ♦

Prej fuqisë me tregues numër i plotë veln $a^{-k} = \frac{1}{a^k}$, pra $a^{-\frac{m}{n}} = \left(a^{\frac{1}{n}}\right)^{-m} = \frac{1}{\left(a^{\frac{1}{n}}\right)^m} = \frac{1}{a^{\frac{m}{n}}}.$

Sipas kësaj, vlen:

Teorema 1. Nëse a është numër real pozitiv dhe $\frac{m}{n}$ është numër racional, ku m është i plotë, kurse n numër natyror, atëherë $a^{-\frac{m}{n}} = \frac{1}{a^{\frac{m}{n}}}.$

E keni të njohur se shënimi i numri racional me thyesën $\frac{m}{n}$. Nuk është i njëjtershëm. Për shembull, $\frac{3}{4} = \frac{6}{8} = \frac{9}{12}, \dots$ Prej kësaj që për çdo numër pozitiv a vlejné barazimet:

$$\left(a^{\frac{m}{n}}\right)^{n \cdot k} = a^{m \cdot k} \text{ dhe } \left(a^{\frac{m \cdot k}{n \cdot k}}\right)^{n \cdot k} = a^{m \cdot k}, \text{ ku } m \text{ është numër i plotë, kurse } n \text{ dhe } k \text{ janë}$$

numra natyrorë, mund të përfundojmë se numrat pozitivë $a^{\frac{m}{n}}$ dhe $a^{\frac{mk}{nk}}$ kanë të njëjtë nk fuqi. Kjo do të thotë se kur shkruajmë fuqi me tregues numër racional, paraqitja nuk varet prej asaj cila thyesë, është e barabartë me $\frac{m}{n}$, do ta shfrytëzojmë.

Shembulli 3. $9^{\frac{3}{6}} = \sqrt[6]{9^3} = \sqrt{9} = 9^{\frac{1}{2}} = 3.$ ♦

Shembulli 4. a) $(-8)^{\frac{1}{3}} = \sqrt[3]{-8} = -2$, kurse për $\frac{2}{6} = \frac{1}{3}$ kemi:

$(-8)^{\frac{2}{6}} = \sqrt[6]{(-8)^2} = \sqrt[6]{8^2} = 2.$ Domethënë, fitojmë $(-8)^{\frac{1}{3}} \neq (-8)^{\frac{2}{6}}$ që nuk është e mundshme,

b) $(-9)^{\frac{1}{2}} = \sqrt{-9}$ nuk ka kuptim në bashkësinë e numrave realë. ♦

Vërejtje. Shprehja $a^{\frac{m}{n}}$, për a numër real negativ dhe $n \neq 1$ nuk është përkufizuar.

Teorema 2. Për çdo numër real pozitiv a dhe b dhe për çdo $\frac{m}{n}$ dhe $\frac{p}{q}$ numra racionalë, ku m dhe p janë të plotë, kurse n dhe q janë numra natyrorë, vlejné këto barazime:

1) $a^{\frac{m}{n}} \cdot a^{\frac{p}{q}} = a^{\frac{m+p}{n \cdot q}},$

2) $a^{\frac{m}{n}} : a^{\frac{p}{q}} = a^{\frac{m-p}{n \cdot q}},$

3) $(ab)^{\frac{m}{n}} = a^{\frac{m}{n}} b^{\frac{m}{n}},$

4) $\left(\frac{a}{b}\right)^{\frac{m}{n}} = \frac{a^{\frac{m}{n}}}{b^{\frac{m}{n}}},$

5) $(a^{\frac{m}{n}})^{\frac{p}{q}} = a^{\frac{m \cdot p}{n \cdot q}}.$

Me të vërtetë, prej përkufizimit për fuqi me tregues racional dhe rregullat për operacione me rrënjë, kemi:

$$\begin{aligned}
 1) \quad a^{\frac{m}{n}} \cdot a^{\frac{p}{q}} &= a^{\frac{mq}{nq}} \cdot a^{\frac{pn}{qn}} = \sqrt[nq]{a^{mq}} \cdot \sqrt[nq]{a^{pn}} = \sqrt[nq]{a^{mq} \cdot a^{pn}} = \sqrt[nq]{a^{mq+pn}} = a^{\frac{mq+pn}{nq}} = a^{\frac{mq}{nq} + \frac{pn}{nq}} = a^{\frac{m}{n} + \frac{p}{q}}, \\
 2) \quad a^{\frac{m}{n}} : a^{\frac{p}{q}} &= a^{\frac{mq}{nq}} : a^{\frac{pn}{qn}} = \sqrt[nq]{a^{mq}} : \sqrt[nq]{a^{pn}} = \sqrt[nq]{a^{mq} : a^{pn}} = \sqrt[nq]{a^{mq-pn}} = a^{\frac{mq-pn}{nq}} = a^{\frac{mq}{nq} - \frac{pn}{nq}} = a^{\frac{m}{n} - \frac{p}{q}}, \\
 3) \quad (ab)^{\frac{m}{n}} &= \sqrt[n]{(ab)^m} = \sqrt[n]{a^m b^m} = \sqrt[n]{a^m} \cdot \sqrt[n]{b^m} = a^{\frac{m}{n}} \cdot b^{\frac{m}{n}}, \\
 4) \quad \left(\frac{a}{b}\right)^{\frac{m}{n}} &= \sqrt[n]{\left(\frac{a}{b}\right)^m} = \sqrt[n]{\frac{a^m}{b^m}} = \frac{\sqrt[n]{a^m}}{\sqrt[n]{b^m}} = \frac{a^{\frac{m}{n}}}{b^{\frac{m}{n}}}, \\
 5) \quad (a^{\frac{m}{n}})^{\frac{p}{q}} &= \sqrt[q]{(a^{\frac{m}{n}})^p} = \sqrt[q]{a^{\frac{mp}{n}}} = \sqrt[q \cdot n]{a^{mp}} = \sqrt[q \cdot n]{a^{mp}} = a^{\frac{mp}{qn}} = a^{\frac{m}{n} \cdot \frac{p}{q}}. \blacklozenge
 \end{aligned}$$

Detyra 1. Njehso:

$$a) 81^{0,25}, \quad b) 3^{-2} \cdot 27^{\frac{1}{3}}, \quad c) \left(\frac{1}{16}\right)^{-0,25} + (0,027)^{\frac{2}{3}} + \left(1\frac{61}{64}\right)^{-\frac{2}{3}}, \quad d) \left(a^{\frac{2}{3}} \cdot b^{\frac{1}{6}}\right) : a^{\frac{1}{4}} \text{ për } a, b > 0$$

Zgjidhje. a) $81^{0,25} = (3^4)^{\frac{1}{4}} = \sqrt[4]{3^4} = 3$ ose $81^{0,25} = (3^4)^{\frac{1}{4}} = 3^{4 \cdot \frac{1}{4}} = 3^1 = 3$,

b) $3^{-2} \cdot 27^{\frac{1}{3}} = \frac{1}{3^2} \cdot \sqrt[3]{27} = \frac{1}{3^2} \cdot 3 = \frac{1}{3}$

c) $\left(\frac{1}{16}\right)^{-0,25} + (0,027)^{\frac{2}{3}} + \left(1\frac{61}{64}\right)^{-\frac{2}{3}} = \left(\frac{1}{2}\right)^{4 \cdot (-\frac{1}{4})} + \left(\frac{3}{10}\right)^{\frac{2}{3}} + \left(\frac{5}{4}\right)^{3 \cdot (-\frac{2}{3})} =$
 $= \left(\frac{1}{2}\right)^{-1} + \left(\frac{3}{10}\right)^2 + \left(\frac{5}{4}\right)^{-2} = 2 + \frac{9}{100} + \frac{16}{25} = \frac{273}{100} = 2,73$,

d) $\left(a^{\frac{2}{3}} \cdot b^{\frac{1}{6}}\right) : a^{\frac{1}{4}} = a^{\frac{2}{3} - \frac{1}{4}} \cdot b^{\frac{1}{6}} = a^{\frac{5}{12}} \cdot b^{\frac{1}{6}} = (a^5 b^2)^{\frac{1}{12}} = \sqrt[12]{a^5 b^2}$

Detyra

1. Shkruaji si rrënjë këto shprehje:

a) $x^{-\frac{1}{4}}$, **b)** $a^{-0,5}$, **c)** $(x+1)^{\frac{3}{2}}$, **d)** $(x-y)^{-\frac{3}{4}}$, **e)** $\sqrt[4]{(a-b)^{-n}}$.

2. Janë dhënë rrënjët të shkruara në formë të fuqive me tregues racional:

a) $\sqrt[3]{a}$, **b)** $n^{-1}\sqrt{a^2}$, **c)** $\sqrt{\frac{1}{a^3}}$, **d)** $\sqrt[m]{x^{-2}}$, **e)** $\sqrt[4]{(a-b)^{-n}}$

3. Kryeji operacionet e shënuara me fuqi:

a) $x^{\frac{2}{3}} \cdot x^{-\frac{3}{4}} : x^{-0,25}$, **b)** $(x^{\frac{1}{2}} - y^{\frac{1}{2}})(x^{\frac{1}{2}} + y^{\frac{1}{2}})$, **c)** $9^{-\frac{1}{2}} + 0,25^{-\frac{3}{2}}$.

4. Njehso:

a) $(x^{\frac{1}{3}} + y^{\frac{1}{3}})(x^{\frac{1}{3}} - y^{\frac{1}{3}})$, **b)** $(x^{\frac{3}{4}} - x^{\frac{5}{6}} - x^{\frac{2}{3}}) : x^{\frac{1}{2}}$,

c) $(x^{\frac{1}{2}} - y^{\frac{1}{2}})^2$, **d)** $(a^{\frac{2}{3}} + 1)^3$

5. Thjeshtojë shprehjen:

$$\text{a) } \left(x^{\frac{1}{2}} + x^{\frac{1}{4}}\right)^{-2}, \quad \text{b) } \left(16a^{\frac{3}{2}}b^{-2}\right)^{\frac{3}{4}}$$

1.8. Shprehjet iracionale

Deri tani u njohtëm me këto gjashtë operacione me numra: mbledhje, shumëzim, zbritje, pjesëtim, fuqizim (me numër natyror dhe tregues të plotë) dhe rrënjëzim. Të gjitha këto operacione quhen, me emrin e përbashkët, **operacione algjebrike**, prej të cilave pesë të parat quhen edhe **operacione algjebrike racionale**, kurse rrënjëzimi – **operacion algjebrik iracional**.

Përkufizimi. Shprehjet të cilat janë përfaqësuar numër herë përfundimtar vetëm operacione racionale, quhen **shprehje racionale**, kurse shprehjet të cilat përveç operacioneve është përfaqësuar edhe operacioni rrënjëzim, quhen **shprehje iracionale**.

Me emër të përbashkët shprehjet racionale dhe iracionale i quajmë **shprehje algjebrike**.

Shembulli 1. Shprehjet racionale janë: $2ab - 3a^2$, $5x^4y^{-2} + 3$, $\frac{x^2y-3}{x^2+1}$, kurse shprehje iracionale janë shprehjet: $2 + \sqrt{3}$, $5x - \sqrt[3]{xy^2}$. ♦

Shprehjet iracionale, njëjtë sikurse edhe racionale, mund të përmbajnë ndryshore, ose të mos përmbajnë ndryshore. Fushën e përkufizimit D të çdo shprehje iracionale, d.m.th., bashkësinë e vlerave të ndryshore (ndryshoreve) për të cilat shprehja iracionale e dhënë ka kuptim, do ta caktojmë prej kushteve: shprehja nënrrënjësore e rrënjëve me tregues çift të rrënjës të jenë jonegativ dhe emëruesi të shprehjeve të jenë të ndryshme prej zeros.

Shembulli 2. Fushën e përkufizimit të shprehjes iracionale $e \frac{2}{x} + \frac{\sqrt{x+5}+3}{x-4}$ caktojmë prej kushteve: $x + 5 \geq 0$, $x \neq 0$ dhe $x - 4 \neq 0$, përkatësisht: $x \geq -5$, $x \neq 0$ dhe $x \neq 4$. Domethënë, kemi $D = [-5, \infty) \setminus \{0, 4\}$. ♦

Në të gjitha detyrat të cilat duhet t'i kryejmë operacionet dhe t'i thjeshtojmë shprehjet, përveç nëse nuk është theksuar ndryshe, do të llogarisim se tanimë është caktuar fusha e përkufizimit të ndryshore (ndryshoreve).

Detyra 1. Kryejni operacionet e shënuara dhe thjeshtojë shprehjen:

$$\text{a) } -2y^3\sqrt{\frac{x}{y^2}} : 3x\sqrt{\frac{y}{x}}, \quad \text{b) } \left(\frac{1}{\sqrt{1-a}} - \sqrt{1+a}\right) : \left(\frac{1}{\sqrt{1-a^2}} - 1\right).$$

Zgjidhje. a) Së pari **ke** ja определиме дефиниционата област на изразите. Така, од $\frac{y}{x} \geq 0$, следува дека $y \geq 0$ и $x > 0$, или $y \leq 0$ и $x < 0$. Јасно, од $y^2 \neq 0$ следува дека и $y \neq 0$. Domethënë, $x, y \in \mathbb{R} \setminus \{0\}$ dhe $xy > 0$. (SEGA) i sjellim rrënjët e dhëna në tregues të njëjtë të rrënjës, kurse pastaj njehsojmë herësin, pra kemi:

$$\begin{aligned} -2y^3\sqrt{\frac{x}{y^2}} : 3x\sqrt{\frac{y}{x}} &= -2y^3\sqrt{\left(\frac{x}{y^2}\right)^2} : 3x\sqrt{\left(\frac{y}{x}\right)^3} = \frac{-2y}{3x}\sqrt{\frac{y^4}{y^3}} = \\ &= \frac{-2y}{3x}\sqrt{\frac{x^5}{y^7} \cdot \frac{y^5}{y^5}} = \frac{-2y}{3xy^2}\sqrt{(xy)^5} = \frac{-2}{3xy}\sqrt{(xy)^5}, \end{aligned}$$

b) Për fushën e përkufizimit kemi

$$1 - a > 0 \text{ d.m.th. } a < 1 ;$$

$$1 + a \geq 0 \text{ d.m.th. } a \geq -1 ;$$

$$1 - a^2 > 0 \text{ d.m.th. } -1 < a < 1 \text{ dhe}$$

$$1 - \sqrt{1 - a^2} \neq 0 \text{ d.m.th. } a \neq 0 .$$

Domethënë, fusha e përkufizimit është $D = (-1, 0) \cup (0, 1)$.

Për $a \in D$, shprehjet i sjellim në emërues të përbashkët, kurse pastaj i thjeshtojmë:

$$\begin{aligned} & \left(\frac{1}{\sqrt{1-a}} - \sqrt{1+a} \right) : \left(\frac{1}{\sqrt{1-a^2}} - 1 \right) = \\ & = \left(\frac{1}{\sqrt{1-a}} - \frac{\sqrt{1+a} \cdot \sqrt{1-a}}{\sqrt{1-a}} \right) : \left(\frac{1}{\sqrt{1-a^2}} - \frac{\sqrt{1-a^2}}{\sqrt{1-a^2}} \right) = \left(\frac{1}{\sqrt{1-a}} - \frac{\sqrt{1-a^2}}{\sqrt{1-a}} \right) : \left(\frac{1 - \sqrt{1-a^2}}{\sqrt{1-a^2}} \right) = \\ & = \frac{1 - \sqrt{1-a^2}}{\sqrt{1-a}} \cdot \frac{\sqrt{1-a^2}}{1 - \sqrt{1-a^2}} = \frac{\sqrt{1-a} \cdot \sqrt{1+a}}{\sqrt{1-a}} = \sqrt{1+a} . \diamond \end{aligned}$$

Te detyrat e këtij lloji duhet të zbatohen operacionet me rrënjë, në mënyrë korrekte të kryhen rend ii operacioneve dhe në fund rrënjët, nëse ka, të shkruhen në formën normale.

Detyra

1. Cakto fushën e përkufizimit të shprehjeve:

a) $\frac{\sqrt{x^2 - \sqrt{x+2}}}{x-3},$

b) $\frac{\sqrt{x+2} - \sqrt[3]{x}}{x+2},$

c) $\frac{\sqrt{2x-1} + x}{\sqrt{x+3}},$

2. Vërteto se: $\frac{1}{2+\sqrt{3}} + \frac{1}{2-\sqrt{3}} = 4$

3. Kryeji operacionet e shënuara dhe thjeshtoj shprehjen:

$$\left(\frac{15}{\sqrt{6}+1} + \frac{4}{\sqrt{6}-2} - \frac{12}{3-\sqrt{6}} \right) \cdot (\sqrt{6}+11).$$

4. Kryeji operacionet e shënuara dhe thjeshtoj shprehjen:

$$\frac{a^2 - 4}{a - 2\sqrt{2a} + 2} : \frac{a + \sqrt{8a} + 2}{12}, \text{ për } a = 26.$$

5. Cakto numrin natyror më të vogël, për të cilin është përkufizuar shprehja $\frac{\sqrt{x}+1}{\sqrt[3]{x-1}}$

DETYRA PËR PËRSËRITJE

1. Njehso:

a) $\sqrt{65^2 - 63^2},$

b) $\sqrt[7]{128},$

c) $\sqrt[4]{0,0081},$

d) $\sqrt[3]{54} + \sqrt[3]{108} - \sqrt[3]{135}$

2. Cilat prej këtyre rrënjëve kanë kuptim në bashkësinë e numrave realë?

a) $\sqrt[4]{-625},$

b) $\sqrt[8]{\frac{3^4}{(-9)^3}},$

c) $\sqrt[3]{7 - \frac{1}{3} + \frac{2}{5}},$

d) $\sqrt[5]{-3,25}$

3. Për cilat vlera të ndryshores x , rrënja ka kuptim?

a) $\sqrt[5]{x+5}$, b) $\sqrt[4]{12-4x}$, c) $\sqrt[3]{\frac{x+1}{x-2}}$, ç) $\sqrt[4]{(2x-4)(x+6)}$

4. Thjeshto:

a) $\sqrt[6]{(-6)^6}$, b) $\sqrt{\frac{100}{(-2)^2}}$, c) $\sqrt[3]{\left(-\frac{1}{27}\right)^3}$, ç) $\sqrt[4]{16x^4}$, për $x \leq 0$.

5. Rrënjët e dhëna zgjeroji me 5:

a) $\sqrt[3]{3^2}$, b) $\sqrt[5]{a^4b}$, për $a, b > 0$, c) $\sqrt[4]{(-3x)^6y^2}$ për $x, y > 0$.

6. Thjeshtoji rrënjët:

a) $\sqrt[16]{64}$, b) $\sqrt{\left(-\frac{1}{3}\right)^{10}}$, c) $\sqrt[4]{(-6x^{12})^{10}y^{12}}$, për $x, y > 0$.

7. Rrënjët e dhëna zgjeroji përkatësisht deri te shumëfishi më i vogël i përbashkët të treguesve të tyre të rrënjëve:

a) $\sqrt{5}$, $\sqrt[3]{7}$ dhe $\sqrt[4]{2}$, b) $\left(\sqrt[3]{\frac{a^2b^4}{5}}, \sqrt[4]{\frac{a^3b^2}{4}}\right)$ dhe $\sqrt[6]{\frac{a^3b}{5}}$ për $a, b > 0$

8. Rrënjët e dhëna thjeshtoji me pjesëtuesin më të madh të përbashkët të treguesve të tyre të rrënjëve, për $a, b > 0$:

a) $\sqrt[4]{81a^6}$, $\sqrt[6]{64a^{18}b^6}$ dhe $\sqrt[12]{25a^{10}}$, b) $\sqrt{9a^4b^8}$, $\sqrt[4]{81a^6b^{12}}$ dhe $\sqrt[6]{25a^{10}b^2}$.

9. Njehso:

a) $\sqrt[3]{-64 \cdot x^3}$, b) $\sqrt{\frac{0,09}{289}}$, c) $\sqrt[5]{\frac{32a^{15}}{b^{20}c^{10}}}$ për $b, c \neq 0$, ç) $\sqrt{a^4b^2} \cdot \sqrt{a^8b^6c^{14}}$ për $a, b, c > 0$
d) $\sqrt[3]{27a^3} \cdot \sqrt[3]{64a^2} \cdot \sqrt[3]{25a} \cdot \sqrt[3]{5a^6}$, dh) $\sqrt[4]{8x^5y^2} : \sqrt[6]{4xy^2}$, për $x, y > 0$, e) $\sqrt{\frac{(x-2)^4}{x(x^2+3)^2}}$, për $x > 0$.

10. Cakto për cilën vlerë të ndryshores x vlejné barazimet:

a) $\sqrt{(3x+2)^2} = 3x+2$, b) $\sqrt{4x^2(x+1)^2} = 2x \cdot (x+1)$,

11. Nxirre shumëzuesin para shenjës së rrënjës:

